

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



Mission
d'Administration
NATIONS UNIES
Intérimaire des
Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Legjislatura e III-të
Më 14.02.2008, në ora 10.30
Salla N-10

Komisioni për
Ekonomi, Tregti, Industri, Energji, Transport dhe Telekomunikacion

Procesverbal

Mbledhjen e drejtoi
Myzejene Selmani – kryetare e Komisionit

Morën pjesë:

Et'hem Çeku, Slobodan Petroviq, Safete Hadergjonaj, Sala Berisha-Shala, Kaqusha
Jashari Haki Shatri, Fatmir Rexhepi, Zef Morina, Berim Ramosaj dhe Múfera Šinik.

Munguan:.....

Nga zyra mbështetëse:

Hasan Tahiri, Advie Morina dhe Armend Ademaj.

Nga: NDI-ja: Vjosa Bajraliu.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;
2. Shqyrtimi i projektligjit për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës 2008;
3. Të ndryshme;

- Rendi i ditës u miratua

I – Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;

Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar të datës 12.02.2008.

II - Shqyrtimi i Projektligjit për Buxhetin konsoliduar të Kosovës 2008;

Kryetarja Selmani tha se përveç P. ligjit për buxhetin e konsoliduar të Kosovës për vitin 2008 kemi edhe tri kërkesa shtesë për trajtimin dhe miratimin e buxhetit të tyre për vitin 2008 si janë:

1. Kërkesa e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM);

2. Kërkesa e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) si dhe të

3. Agjencionit të Autoritetit Rregullativ (ART),

-Ajo kërkoi nga të pranishmit që diskutimet të jenë sa më konkrete duke pasur parasysh edhe afatin shumë të shkurtër sepse P. ligji për buxhetin e konsoliduar të Kosovës për vitin 2008 dot shqyrtohet në seancën e Kuvendit me 15.02.2008.

Haki Shatri – Vlerësoi se P. ligji për buxhetin e konsoliduar të Kosovës për vitin 2008 në parim është i qëndrueshëm dhe i avancuar në krahasim me buxhetin e viti 2007. Përparësitë qëndrojnë në faktin se janë shtuar investimet kapitale edhe pse ka vend për debat e korrigjime. Ai sugjeroi të pranishmit se nuk është e preferueshme që të bëhen ndryshime të mëdha sepse pastaj ato reflektohen në parametrat e buxhetit të njësit tjera. Sa i përket kërkesave të tri njësive buxhetore të (KPMM-së të ZRRE dhe të ART-së) në komisionin për buxhet është debatuar dhe pritet përsëri këto kërkesa të trajtohen në mbledhjen e të njëjtit komision ku edhe janë ftuar përfaqësuesit e tyre për t'i argumentuar faktet. Sipas tij komisioni për ETIETT nëse ka amendamente apo rekomandime do duhej që të përgatiten dhe harmonizohen me komisionin për buxhet nga fakti se edhe koha është e kufizuar gjerë me 29.02.2008 për miratim në Kuvendin e Kosovës.

Safete Hadergjonaj – ishte e mendimit se parashikimet në përgjithësi për mallra dhe shërbime duhet zvogëluar në favor të investimeve kapitale. Për këtë korrigjim ne do duhej të kishim edhe fakte të argumentuara me projekte të cilat tani për tani nuk i disponojmë. Lidhur me kërkesat e tri njësive buxhetore (KPMM,ZRRE dhe ART) propozoi që debati të vazhdoi edhe në komisionin për buxhet ku përfaqësuesit e komisionit do t'i përcjellin edhe propozimet e këtij komisioni. Ajo gjatë diskutimit të saj u deklarua se sidomos për segmentin që kishte të bënte me paga dhe shërbime e mallra në tri agjencitë nuk pajtohet dhe propozon që shumat buxhetore të korrigjohen në favor të investimeve kapitale..

Et'hem Çeku- Ai propozoi që të ftohen përfaqësuesit e këtyre tri njësive buxhetore Ai shprehu keqardhje për zvogëlimin e shumës buxhetore për Ministrinë për Energji e Miniera. Lidhur me buxhetin e këtyre tri njësive e sidomos të KPMM-së dhe të ZRRE tha se duhet të jemi të vëmendshëm dhe të kemi parasysh rëndësinë e funksionalitetit të tyre për zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik e sidomos të sektorit të energjisë duke përfshirë minierat. Një pjesë të fjalës ia përkushtoi edhe politikës kadrovike në këto dy institucione e që janë në rrezik të shpërbërjes për shkak të pagave të ulëta. . Ai tha se duhet të kërkojmë informacione sa me te qarta lidhur me buxhetin e tyre e sidomos të KPMM – së ashtu që kërkesa lidhur me shtimin- korrigjimin e buxhetit të jetë sa më i

qëndrueshëm. Ai tha se duhet gjetur mënyra mbështetjeje financiare sepse këto njësi bartin edhe një pjesë të madhe të politikës zhvillimore të ekonomisë në përgjithësi.

Kryetarja Selmani– disa here ndërhyri duke i lutur anëtarët që në diskutimet e tyre të jenë sa më konstruktiv dhe të bëjnë propozime konkrete .

Fatmir Rexhepi – Ai në përgjithësi shprehi pakënaqësi dhe pa pajtueshmëri me politiken e ndarjes buxhetore. Sipas tij ky projekt në vete përmban një politikë jo të drejtë parimore të ndarjes buxhetore. Si shembull të një ndarje jo të drejtë apostrofoi disa subjekte-ministri si ajo e ASHT, KRS, Transport e Telekomunikacion, Ambient e Planifikim Hapësinor. Me qenë se vërejtjet janë të shumta dhe në komision nuk ka mundësi që të amendamentohen e rekomandohen për shkak të kohës së shkurtër unë vërejtjet e mija do t'i parashtojë në seancën e Kuvendit. Në vazhdim ai në parim i mbështeti kërkesat e tri njësive buxhetore (KPMM; ZRRE; ART) për të cilat sipas tij komisioni duhet të merr përgjegjësinë e miratimit të rekomandimeve. Në vazhdim ai paralajmërojë të pranishmit se nuk do ta votojë këtë projektbuxhet, nëse nuk bëhen ndryshime thelbësore e sidomos në favor të investimeve kapitale.

Zef Morina- vlerësoi se është një projektbuxhet shumë me i avancuar se buxhetet më të hershme. Politikat buxhetore janë të orientuara në projekte kapitale e që është për tu përshëndetur. Sa i përket kërkesave të tri njësive ai tha se vlen të trajtohen por kishte vërejtje në segmentin për shërbime e mallra dhe të pagave shumë të larta në raport me mesataren. Sipas tij për një analizë dhe ndarje të qëndrueshme duhet më shumë kohë andaj në mungesë të kohës dhe analizave të mirëfillta ai propozoi që në parim të zvogëlohen shpenzimet luksoze, (të mbesin propozimet e ministrisë) ndërsa shpenzimet kapitale për KPMM-ën të mbesin të propozuarat sipas KPMM-së. Në vazhdim ai sugjeroi anëtarët që komisioni mundësisht të jetë unik dhe të ketë qëndrim të përbashkët rreth amendamentimit të këtij projekti.

Kaqusha Jashari –Meqenëse si tha nuk kamë njohuri për buxhetet e viteve të më hershme, tani e kam pak sa më vështirë të vlerësoi qëndrueshmërinë e këtij projekti por si do që të jetë ajo vlerësoi se ky projekt është një projektbuxhet i mirë në parim. Sipas saj projekti ka avancime në fushën e investimeve kapitale e që janë bazë për zhvillim duke përmendur si shembull investimet në infrastrukturë e që është parakusht për investime e zhvillime tjera. Në parim tha se nuk kamë vërejtje andaj edhe do ta mbështesë përveç segmentit që ka të bëjë me pagat në tri agjencitë e përmendura nga fakti se janë të larta dhe të pa arsyeshme.

Sala Berisha-Shala – ajo vlerësoi se është shumë vonë për të bërë analiza dhe propozime të qëndrueshme për ndryshim e harmonizim të mirëfilltë. Sipas saj nuk është parimore të vlerësohet sa dhe cilës njësi i janë ndarë më shumë apo më pakë sepse kjo është më shumë çështje konceptioni. Ajo pastaj u përqendrua te kërkesat e tri njësive buxhetore ku sipas saj buxheti i tyre përfaqësohet duhet të jetë ai i koncipuar nga MEF-i. Si argument ajo tha se e ka parasysh nismën për plotësim ndryshimin e Ligjit për miniera dhe minerale (ende nuk është shpallur) me të cilin ndryshim për KPMM-ën parashihet zvogëlimi i administratës, kufizimi i kompetencave, buxheti etj.

Berim Ramosaj – mbështeti në parim projekt buxhetin duke sugjeruar se në parim duhet t'i mbështesim proceset dhe projektet zhvillimore racionale. Sipas tij qeverisja aktuale nuk ka programe zhvillimore për komuna në bazë të asaj që u dëgjua, andaj në të ardhmen duhet të llogarisim në vetë financimin e komunave theksoj në diskutimin e tij z. Ramosaj.

-Vërejtje e përgjithshme e të gjithë anëtarëve ishte se materiali (tri kërkesat e agjencive) është shpërndarë me vonesë.

Sekretaria njoftoi se shpërndarja me vonesë ka ndodhur nga fakti se, materiali është marr vetëm një ditë para mbledhjes dhe jo për mesë procedimit zyrtar, por përmes Komisionit për buxhet.

Kryetarja – vlerësoi se sipas diskutimit të përgjithshëm komisioni përfundon me këto konkluzione si vijon:

- Në parim mbështetet Projektbuxheti i konsoliduar i Kosovës për vitin 2008
- Për tri njësit buxhetore (KPMM; ZRRE dhe ART) ka mundësi që buxheti për paga dhe mëditje si dhe për mallra e shërbime të zvogëlohet në favor të shpenzimeve kapitale.
- Këtë qëndrim do ta prezantojnë, arsyetojnë dhe harmonizojnë përfaqësuesit e Komisionit për ETIETT (Kryetarja Selmani, Et'hem Çeku, Zef Morina) si dhe anëtarët tjerë që dëshirojnë të marrin pjesë në Komisionin për Buxhet e që mbahet të njëjtën ditë në orën 13.00.

-Komisioni njëzëri u pajtua me konkluzionet e lartë shënuara.

Mbledhja përfundoj në ora 11.40

Kryetarja e Komisionit:
Myzejene Selmani